

Protokolli i kuvendit të XIII. të përgjithshëm

Pjesëmarrës 36 (1 ka ardhur me vone) anëtarë me të drejtë vote.

Kryesues i ditës: Enver Foniqi

Protokollon : Visar Kryeziu

Temat e ditës

-Zgjedhja e kryesuesit dhe procesmbajtesit te Kuvendit

-Zgjedhja e komisionit zgjedhor

-Miratimi i protokollit te kuvendit te kaluar

-Raporti vjetor i kryetarit

-Raporti i pergjithshem i arkatarit

-Rraportti i auditorit

-Miratimi i raportit financiar

-Zgjedhja e auditorit

-Votimi per kryetar

-Votimi per anetar te kryesise

-Mbedhja e shkurter e kryesise se re dhe prezantimi

-Te ndryshme

Zgjedhja e kryesuesit dhe procesmbajtesit

Ne fillim e mori fjalen kryetari i deritanishem i shoqates Isa Abdyli per te pershendetur te pranishmit!

Fton te votohen kryesuesi i kuvendit si dhe procesmbajtesi i kuvendit!

U propozuan Enver Foniqi per kryesues te kuvendit kurse per procesmbajtes u propozua Visar Kryeziu!

Kuvendi i votoi te propozuarit me shumice votash!

Zgjedhja e komisionit zgjedhor

Enver Foniqi si kryesues i kuvendit mori ne udheheqje kuvendin dhe para se te shkoj me pikat e rendit te dites, tha se shoqata duhet te jete e bashkuar ashtu siç kemi qene deri me tash.

Ruhan Foniqi, Seid Xhelili edhe Bekim Haliti u propozuan per komision zgjedhor si dhe u votuan me shumice votash nga kuvendi!

Komisioni zgjedhor beri numerimin e te pranishmeve, ku te pranishem ne kuvend me te drejte vote ishin: 36 anetar te pranishem (ne nderkohe ka arritur edhe nje anetare i ri qe morri pjese ne votimin e kryesise)

Miratimi i protokollit te vitit te kaluar

Protokolli i vitit kaluar ishte publikuar disa dite me heret dhe ne kuvend u hodh ne votim si dhe u miratua nga kuvendi me shumice votash.

Raporti vjetor i kryetarit

Kryetari i shoqates Ismet Abdyl e mori fjalen dhe i pershendeti te pranishmit, si dhe te gjithe antaret e shoqates qe kane kontribuar ne shoqate. Gjithashtu Ismeti i pershendeti edhe sponzoret e shoqates, si dhe permendi te gjitha projektet e realizuara nga shoqata per vitin 2019 (Projektet jane te publikuara ne webfaqe te shoqates).

Ne fund kryetari shprehu ngushellime per ish anetarin e kryesise se shoqates Bahri Zeqirovcie si dhe per anetarin e shoqates Dalip Foniqi qe poashtu ka nderruar jete ne vitin 2018.

Raporti i arkatarit

Mori fjalen arkatar i shoqates per 2018 Avni Kastrati. Ai tregoi per te hyrat dhe daljet nga konto e shoqates ne te cilat tha se cdo gje ka shkuar ne rregull por qe kete me se miri mund ta vertetoj auditori i shoqates.

Raporti i auditorit

Mori fjalen auditori Enver Tahiri, ku tha se jane takuar dhe kontrolluar te gjitha hyrje dhe daljet nga konto e shoqates dhe gjithqka eshte ne rregull me te hyrat e daljet. Gjithashtu Enver Tahiri propozoi qe te shtohet edhe nje pike e rendit te dites, si te ndryshme:
Ky propozim u miratua nga kuvendi me shumice votash.

Miratimi i raportit financiar

Nebih Huruglica , mori fjalen dhe tha se si eshte e mundur me i pas 250 anetar shoqata kurse te hyrat jane me pak. Nebiu tha qe ata anetare. qe nuk jane aktual per kete vit te hjekten nga lista.
Agron Zahiri mori fjalen dhe tha se ka anetare te shoqates qe kane paguar ne nje vit kurse tjetrin vit nuk kane pagu dhe keshtu ne kemi diskutuar edhe me heret ne kuvend.

Zgjedhja e auditorit

Agron Zahiri propozon qe nje nga auditoret e viti te kaluar te largohet kurse njeri te mbetet, shkak i pervojës.
U propozua Nebi Huruglica dhe Burhan Hajdari per auditor te shoqates per vitin 2019.

Zgjedhja e kryetarit

Kryesuesi Enver Foniqi kerkon nga kuvendi qe te kene propozime per kryetare te shoqates. Nga kuvendi njehere nuk kishte propozime ndersa kryesuesi tha qe pasi qe nuk ka nga kuvendi propozim per kryetar, ateher kryesia propozon per kryetare te shoqates Ismet Abdylin perseri per vitin 2019. Pas nje debati te shkurter, kuvendi propozoi Bekim Halitin, Agron Zahirin per qe keta nuk pranuan perveq Burim Zahiri dhe Sevdail Xhelili te cilet pranuan. U debatua qe kandidat per kryetar te jene ai i cili ka qene nje here ne kryesi, e jo kanmdidati per kryetar te jete nga dikush qe nuk ka qene asnjehere ne kryesi. U propozua nga Rabit Zahiri qe dy kandidatet qe u propozuan nga kuvendi njherit te zgjedhen njeri nga ta me vota e pastaj fituesi te shkoj ne zgjedhje me kandidatin e kryesise per kryetare te shoqates 2019.

Nebiu proozoi qe kandidatet per kryetar te jene ata te cilet kane paguar rregullisht anetaresine ne shoqate!

U votua me shumice votash propozimi i Rabit Zahirin.

Kuvendi votoi se pari per dy kandidatet e propozuar nga vete kuvendi dhe dy vota me shume mori: Sevdaili Xhelili mori 18 vota kurse Burim Zahiri 16 vota.

Kjo do te thote qe Sevdail Xhelili do te jete kunderkandidat i Ismet Abdylit per kryetare te shoqates per 2019 te cilet do te garojne ne mes vete.

Te propozuarit u votuan nga kuvendi me vota te fshehura, dhe rezultati eshte ky:

Gjithsej jane 36 vota jane, kur rezultati i votimeve eshte baraz 18 me 18 per secilin Ismetin dhe Sevdailin.

Diskutohet se si te vepohet me tutje per perzgjedhjen e kryetarit te ardhshem te shoqates. U propozua qe kryetar te shoqates te mbetet Ismet Abdylit kurse nenkryetare Sevdail Xhelili, ku me kete propozim u pajtuan edhe vete Sevdaili dhe Ismeti.

Votimi per kryesine e shoqates

Kryesuesi kerkoi qe te kete propozime nga kuvendi per anetare te kryesise, kurse 5 kandidatet qe marrin vota me shume do te hyjne ne kryesi. Keshtu Kryetari dhe Nenkryetari jane perzgjedhur njehere nga kuvendi ndersa te gjithet e propozuarit tjere nga kuvendi te garojne per 5 vendet e lira ne kryesi.

U propozuan dhe vetepropozuan:

Avni Kastrati
Musa Halili
Ruhan Foniqi
Bekim Haliti
Muhammed Guda
Qendresa Sadriu
Burim Zahiri
Armend Murtezi
Shefik Nuredini

Kuvendi votoi, kurse rezultati ishte ky:

Avni Kastrati 27 vota
Bekim Haliti 27 vota
Ruhan Foniqi 26 vota
Qendresa Sadriu 24 vota
Musa Halili 19 vota
Armend Murtezi 18 vota
Muhammed Guda 17 vota
Burim Zahiri 14 vota
Shefik Nuredini 4 vota

Mbledhja e shkurter e kryesise se re dhe prezantimi

U mbajt nje mbledhje e shkurter e kryesise se re, ku kryesuesi i kuvendit njoftoi per perberjen e kryesise se re:

Ismet Abdyli kryetare
Sevdail Xhelili nenkryetare
Qendresa Sadriu sekretare
Avni Kastrati arkatar
Bekim Haliti
Ruhan Foniqi
Musa Halili

Te ndryshme

Enveri propozon qe mos te votohet cdo vit kryesia e kryetari i shoqates por per cdo dy apo tri vite te mbahen zgjedhjet. Musa Halili thote qe per cdo 4 vite te zgjedhet kryetari e kryesia.

Agron Zahiri thote qe me ligj te Zvicres jemi te obligueshem te mbajme kuvendin per cdo vit. Qendresa thote qe per cdo dy vjet te zgjidhet kryesia e re.

U hodh ne votim qe kuvendi te mbahet cdo vit, kurse kryesia ka mandat per dy vite. Agroni thote ateher duhet te ndrrohet edhe statuti qe kryetari i shoqates te jete jo per nje vit, por per nje mandat. Kuvendi votoi me shumice Per, kurse dy ishin kunder. Raporti financiar behet cdo vit qe te miratohet nga kuvendi. Rabbit Zahiri thote qe kuvendi te kete te drejte pas nje viti ta shkarkoj kryesine nese nuk shkojne punet ne rregull, dhe me kete u pajtuan te gjithë.

Agron Zahiri thote qe ftesat anetareve ti behen sipas statutit qe thote se nje jave para kuvendit te shperndahen ftesat.

Nebi Huruglica thote se si mundemi ti motivojme te tjeret qe te behen anetare te shoqates. Ismet Abdylly thote se kryesia eshte e ngarkume dhe se kerkon qe edhe te tjeret te veteofrohen qe te na ndihmojne dhe te marrin pergjegjesi.

Enver Tahiri thote se ky kuvend i sotit eshte kuvendi me i dobët i organizuar deri me tash sepse herave te kaluara kemi marr njoftimin permes ftesave si dhe permes SMS-ve kurse kete vit jo.

Ismeti tregon se ka probleme per transferimin e rrogave te punetoreve, por kryesia ka diskutuar qe punetoret e shoqates duhet te kene patjeter nje konto te bankes per me mund me ia dergu rrogen permes bankes.

Agroni propozon qe te votohet nese duan te informohen permes postes apo ne menyra elektronike! Me shumice votash u votua qe te infortmohen ne menyre elektronike.

Rrogat punetoreve ti shkoj ne konto e jo ti ipen ne dore, eshte propozim i Enver Tahirit dhe kerkon qe te votohet nga kuvendi. Kuvendi me shumice votash votoi per propozimin e Enverit.